



Prishtinë, 15 nëntor 2018
Kodi i ZRRE-së: V_1070_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Neni 15, Nenin 26, Nenit 28 paragrafi 2, nënparagrafi 2.1, Nenin 30, Nenin 32 paragrafin 2 nënparagrafi 2.1, Nenin 34 dhe Nenin 38 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 6 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085)
- Dispozitat e Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla Nr.07/2017);
- Marrëveshjes për Blerje të Energjisë Elektrike (MBA) të lidhur mes ndërmarrjes "Air-Energy" SH.P.K dhe KOSTT SH.A, si dhe
- Aplikacionin për Licencim të Aktivitetit të Prodhimit të Energjisë Elektrike të dorëzuar në Rregullator me datë 17.07.2018 nga ndërmarrja "Air-Energy" SH.P.K, adresa Rruga, Rr. Isa Boletini, n.n., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur me datë 15 nëntor 2018, nxori këtë:

VENDIM

- I. LËSHOHET Licencë E PËRKOSSHME** për prodhim të energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme të energjisë nga Parku me Erë "Kitka" ndërmarrjes "Air-Energy" SH.P.K, me numër licence ZRRE/Li_62/18, për periudhën nga **11.10.2018** kur gjeneratori ka hy në operim komercial, e deri me **10.10.2019**.
- II. Obligohet** ndërmarrja "Air-Energy" SH.P.K që brenda afatit të dhënë në pikën I të dispozitivit të këtij Vendimi, të sjellë në Rregullator Lejen Mjedisore të Integruar për gjeneratorin në fjalë, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
- III. Afati i Licencës i dhënë në pikën I të dispozitivit të këtij Vendimi, do rishikohet dhe ndryshohet pas sigurimit të Lejes Mjedisore të Integruar të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.**



Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (Rregullatori) me datë 17.07.2018 ka pranuar Aplikacionin me dëshmitë përkatëse për Licencim të aktivitetit të Prodhimit të energjisë elektrike në Kosovë nga Ndërmarrja "Air-Energy" SH.P.K., nga gjeneratori WIND PARK KITKA, me kapacitet të instaluar prej 32.4MW.
- Për licencim të aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, përveç tjerash kërkohet edhe Leja Mjedisore e Integruar. "Air-Energy" SH.P.K. në pamundësi të nxjerrjes së Lejes Mjedisore të Integruar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), ka dorëzuar në Rregullator Kërkesën e dorëzuar në MMPH me datë 18.09.2018 për t'u pajisur me Leje Mjedisore të Integruar, për të cilën kërkesë ende nuk kanë marrë përgjigje nga MMPH.
- Rregullatori, duke u bazuar në Nenin 5 paragrafin 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, i lëshon licencë të përkohshme ndërmarrjes në fjalë, për periudhën e paraparë si në dispozitiv të këtij Vendimi, me kusht që të sillet në Rregullator Leja Mjedisore e Integruar, brenda dymbëdhjetë (12) muajsh nga data e hyrjes në operim të gjeneratorit të kësaj ndërmarrjeje.
- Nëse i Licencuari brenda afatit të përcaktuar me pikën II të dispozitivit të këtij Vendimi e sjell në Rregullator Lejen Mjedisore të Integruar, atëherë Rregullatori do lëshoj Licencë për prodhimi të energjisë elektrike, ashtu siç parashihet me Nenin 32 paragrafi 2.1 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.
- Sipas Nenit 8.1 të Rregullës për licencimin e aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, ndërmarrjet që aplikojnë për Licencim në Rregullator duhet të njoftojnë përmes gazetës palët e interesit se kanë dorëzuar një aplikacion në Rregullator për Licencë të prodhimit të energjisë elektrike dhe se ai aplikacion është në fazën finale për marrje të licencës. Palët e interesit kanë të drejt të kundërshtojnë aplikacionin, nëse dëshmojnë ndonjë parregullsi të tij.
- Ndërmarrja "Air-Energy" SH.P.K, me 26.10.2018 ka publikuar njoftimin në gazetë, në pajtim me paragrafin e sipërpërmendur. Palët e interesit nuk kanë kundërshtuar këtë aplikacion.
- Rregullatori ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar sipas udhëzimeve të Rregullatorit, kërkesave të parapara në Aplikacionin për Licencim të aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike dhe legjislacionit në fuqi, kështu që pas vlerësimit të aplikacionit dhe dëshmimeve tjera të bashkangjitura aplikacionit të ndërmarrjes "Air-Energy" SH.P.K, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

IV. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.



Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.

Vendimi i dërgohet:

- Ndërmarrjes "Air-Energy" SH.P.K,
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Bordi i Rregullatorit:

Arsim Janova, u.d. Kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar